



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë - INSI” Sh.P.K. të datës 02.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 28.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Master plani për rigjenerimin e lagjes Kolovica - Ritender” me nr. të prokurimit 616-23-5145-2-1-1/1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë - INSI” Sh.P.K. të datës 02.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 28.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Master plani për rigjenerimin e lagjes Kolovica - Ritender” me nr. të prokurimit 616-23-5145-2-1-1/1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik “Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë - INSI” si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë - INSI” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 02.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 28.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Master plani për rigjenerimin e lagjes Kolovica - Ritender” me nr. të prokurimit 616-23-5145-2-1-1/1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet kryesore të parashtruesit janë cituar si në vijim: " Sipas kërkesës në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, nënkuptohet se nuk ka qenë kërkesë e AK që diploma të jetë e nostrifikuar, apo që eksperti i propozuar i shkencave shoqërore biologji-drejtimi i ambientit të paraqes dëshmi të referencave për përvojën e punës për vitet paraprake. Andaj, AK me rastin e eliminimit përkatësisht anulimin të aktivitetit në tërësi ka bërë shkelje të dispozitave të LPP".

Fillimisht duhet sqaruar se kërkesa e dosjes së tenderit për të cilën bëhet fjalë është lidhur me kapacitetin teknik dhe/ose profesional të formuluar si në vijim:

2.OE-ik duhet te ofroj dëshmi per stafin profesional dhe ate si vijon: - Master i juridikut, minimum 3 vite pervoje pune pune pas diplomimit. -Master i shkencave shoqerore biologji-drejtimi i ambientit ,minimum 3 vite pervoje pune pune pas diplomimit.	2.CV-ja, diploma, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.
--	--

Përmes administrimit të dokumenteve me të cilat ka ofertuar parashtruesi është gjetur që sa i përket kërkesës për master të juridikut, parashtruesi nuk ka dorëzuar fare diplomën e studimeve master mirëpo në vend të kësaj ka dorëzuar në lloj të një çertifikate për përfundimin e një trajnimi/programi që nuk është as i licencuar dhe as i akredituar në Republikën e Kosovës. Ky fakt nuk është fare kontestues as për vet parashtruesin pasi që në pretendimin ankimor parashtruesi nuk e konteston të kundërtën mirëpo aludon se autoriteti kontraktues ka mundur të kërkoj sqarime shtesë. Megjithatë në rastin konkret komisioni vlerësues ka gjetur se nuk bëhet fjalë fare për diplomë të studimeve master sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit prandaj nuk ka pasur hapësirë për të kërkuar sqarime shtesë. Në këtë formë është gjetur se i njëjti nuk e përmbushë këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Ngjashëm edhe sa i përket kërkesës për master të biologjisë, komisioni vlerësues ka gjetur se parashtruesi nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për përvojën e punës që sipas DT është kërkuar 3 vite pas diplomimit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.10.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 2 nga 2

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net